



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

PRISHTINË, 22 DHJETOR 2010
NR. REF.: RK 77/10

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 88/10

Parashtruesi

Agim Paca

kundër

Enver Hasanit, ish Rektor në Universitetin e Prishtinës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi është z. Agim Paca, me banim në Prishtinë.

Pala kundërshtare

2. Pala kundërshtare është ish Rektori i Universitetit të Prishtinës (në tekstin e mëtutjeshëm: UP), z. Enver Hasani (në tekstin e mëtutjeshëm: Pala kundërshtare).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon që pala kundërshtare i ka shkelur këto ligje dhe akte nënligjore:
 - a. Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës;
 - b. Ligjin për Arsim të Lartë të Kosovës;
 - c. Statutin e UP-së;
 - d. Udhëzimin Administrativ për procedurat për barasvlerë dhe nostrifikim të diplomave të pranura në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, të lëshuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (në tekstin e mëtutjeshëm: MASHT) nr. 15/2003 neni 4.1 pika g); dhe
 - e. Rregulloret dhe procedurat e zgjedhjeve në Universitetin e Prishtinës në vitin 2009.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: Kushtetuta), neni 22 i Ligjit nr. 03L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtutjeshëm: "Ligji) dhe neni 54(b) i Rregullores së Punës Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: Rregullorja e Punës).

Procedurat në Gjykatë

5. Më 27 shtator 2010, parashtruesi ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: Gjykata).
6. Më 21 tetor 2010, kërkesa iu komunikua palës kundërshtare e cila nuk ka paraqitur asnjë koment.
7. Më 17 dhjetor 2010, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarja Snezhana Botusharova (kryesuese), Zëvendëskryetari Kadri Kryeziu dhe gjyqtarja Iliriana Islami, shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues Ivan Čukalović dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmërinë e kërkesës.
8. Z. Enver Hasani, në cilësinë zyrtare, si Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nuk ka marr pjesë në asnjë fazë pas regjistrimit të kërkesës dhe kërkoj nga Gjykata që të përjashtohet nga pjesëmarrja në shqyrtim. Gjykata miratoi kërkesën e tij.

Përmbledhje e fakteve

9. Përveç pretendimeve të tij, parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë dokument në mbështetje të kërkesës së tij.

Pretendimet e parashtruesit

10. Më 5 korrik 2006, Senati i kryesuar nga ish Rektori i UP-së, Dr. Enver Hasani, mbajti takim ku Dr. Enver Hasani u zgjedh për titullin akademik Profesor i asocuar në Fakultetin Filozofik, Departamenti i Shkencave Sociale, ndonëse nuk e kishte paraqitur asnjë dokument për të dëshmuar që ai e posedon vlerësimin e barasvlerësimit dhe nostrifikimit të doktoraturës së tij.
11. Për më tepër, ai e ka pranuar titullin akademik të Profesorit të asocuar në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës derisa ka qenë rektor i UP-së, ndonëse nuk iu

ka nënshtruar procedurës për vlerësimin e barasvlerës dhe nostrifikimit gjë që është në kundërshtim me Ligjin për Arsim të Lartë, neni 4.1(g) dhe Statutin e Universitetit të Prishtinës. Në këtë mënyrë ai ka arritur, përmes Senatit të UP-së, të sigurojë zgjedhjen e tij për titullin akademik të Profesorit të asocuar në mënyrë të paligjshme.

12. Më 30 qershor 2009, në takimin e Senatit të UP-së, Dr. Enver Hasani, duke keqpërdorur përgjegjësitë e tij si ish Rektor i UP-së, në mënyrë të paligjshme arriti që të zgjidhet për titullin akademik të Profesorit të rregullt në të "Drejtën Ndërkombëtare Publike" në Fakultetin Juridik të UP-së. Në bazë të dispozitave të Statutit të UP-së dhe Ligjit për Arsim të Lartë në Kosovë, Dr. Enver Hasani, nuk ka mundur të zgjidhet për këtë titull akademik për këto arsye:
 - a. Nuk kanë kaluar 4 vjet nga zgjedhja e tij e fundit në vitin 2006 për titull akademik të Profesorit të asocuar (nenet 182, 183, 184 të Statutit të Universitetit të Prishtinës);
 - b. Nuk ka dorëzuar punim profesional apo shkencor që do të vlerësohej si "kontribut profesional apo shkencor", e që do ta mundësonte zgjedhjen e parakohshme për titull akademik në bazë të meritave dhe suksesit të arritur;
 - c. Gjatë vitit 2009, nuk ka pasur konkurs për përzgjedhjen e profesorit në fushën e të Drejtës Ndërkombëtare Publike në Fakultetin Juridik në UP;
 - d. Këshilli i Profesorëve në Fakultetin Juridik nuk e ka themeluar komisionin e vlerësimit i cili do të ishte përgjegjës për vlerësimin e asaj nëse kandidatët potencial i plotësojnë kushtet e parapara në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Statutin e UP-së për ngritjen në titujt akademik. Si rezultat, në vitin 2008-2009 nuk është hartuar asnjë raport i vlerësimit i cili do të tregonte nëse ka qenë Dr. Enver Hasani, apo ndonjë kandidat tjetër i cili e ka merituar që ta fitojë titullin akademik të Profesorit të rregullt në të "Drejtën Ndërkombëtare Publike" në Fakultetin Juridik (në bazë të neneve 180 dhe 181 pika 5, të Statutit të UP-së);
 - e. Gjatë vitit 2008-2009, Këshilli i Profesorëve në Fakultetin Juridik nuk e ka shqyrtuar asnjë raport të komisionit të vlerësimit për ta parë nëse janë plotësuar kushtet ligjore që Dr. Enver Hasani, apo ndonjë kandidat tjetër, ta fitojë titullin akademik të Profesorit të rregullt në të "Drejtën Ndërkombëtare Publike" në Fakultetin Juridik, siç kërkohet në bazë të konkursit publik të shpallur nga Universiteti i Prishtinës; dhe
 - f. Në vitin 2008-2009, Këshilli i Profesorëve në Fakultetin Juridik në UP nuk ia ka propozuar Senatit zgjedhjen e Dr. Enver Hasanit për titullin akademik të Profesorit të rregullt në të "Drejtën Ndërkombëtare Publike".
13. Parashtruesi më tutje pretendon që në muajt maj dhe qershor 2009, të gjitha fakultetet e UP-së kanë mbajtur zgjedhje për anëtarë të Këshillit të fakultetit, kryesi të fakulteteve dhe kryesi të UP-së. Gjatë këtyre zgjedhjeve, Dr. Enver Hasani, duke keqpërdorur përgjegjësitë e tij si ish Rektor i UP-së dhe duke pretenduar rrejshëm që ka qenë i punësuar në Fakultetin Juridik të UP-së, arriti të zgjidhet anëtar në Këshillin e Fakultetit Juridik, ndonëse ishte emëruar si profesor me titullin akademik të Profesorit të asocuar në Fakultetin Filozofik të UP-së më 5 korrik 2006. Kurse ka mundur të aplikojë për anëtar të Këshillit të profesorëve vetëm në Fakultetin Filozofik. Ndonëse pa konkurs dhe pa propozim të Këshillit të Fakultetit Juridik, ai në mënyrë të paligjshme u zgjodh profesor pranë Fakultetit Juridik.

14. Në vitin 2009, parashtruesi pohon që i ka ngritur këto çështje në Këshillin e Fakultetit Juridik, por nuk është bërë asnjë shqyrtim i kësaj çështjeje për arsye se ata nuk merreshin me të kaluarën.
15. Përfundimisht, parashtruesi deklaroi se "Paraqitja e lëndëve kundër Enver Hasanit në Gjykatat e Kosovës është e kotë për arsye se ai ushtron ndikim të fuqishëm mbi gjyqtaret, pasi që një kohe të gjatë ka qenë anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kryetar i Komisionit për intervistim dhe propozim për zgjedhje të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës".

Vlerësimi i pranueshmërisë së Kërkesës

16. Për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shikojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë të parapara në Kushtetutë dhe të shpjeguara edhe me tutje në Ligj dhe Rregullore të Punës.
17. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës i cili thotë:
"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".
18. Neni 48 i Ligjit parasheh:
"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".
19. Në kuptimin e Kushtetutës, pala e dëmtuar është person fizik apo juridik (shih rastin e Universitetit AAB-RIINVEST sh.p.k. kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rasti Nr. KI 41/09) të drejtat kushtetuese të të cilit janë prekur drejtpërsëdrejti apo në mënyrë të tërthortë nga një masë apo akt i autoritetit publik. Personi i cili nuk është prekur në këtë mënyrë nuk e ka cilësinë e viktimës pasi që kushtetuta nuk parasheh *actio popularis* për të. Me fjalë tjera, një parashtrues nuk mund të ankohet në mënyrë abstrakte lidhur me masat e autoriteteve publike të cilat nuk kanë vlejtur personalisht për ta, siç është edhe rasti në fjalë pranë kësaj Gjykate.
20. Në këtë rast, parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi që, prima facie, tregojnë se ka shkelje të të drejtave të tij/saj të garantuara me Kushtetutë (shih Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së lidhur me Pranueshmërinë e Kërkesës nr. 53363/99 i datës 31 maj 2005).
21. Rrjedhimisht, parashtruesi nuk është palë e autorizuar dhe kërkesa duhet të hedhet si e Papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit, si dhe nenit 54 (b) të Rregullores së Punës, në seancën e datës 22 dhjetor 2010, njëzëri:

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit.
- III. Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Ivan Čukalović, d.v.



Zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese

Mr. sc. Kadri Kryeziu, d.v.